

LIGJI PËR PROKURORIN E SHETIT¹

Teksti i integruar me ndryshimet dhe plotësimet e bëra në baze të:

Ligjit nr. 05/l-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/l-225 për Prokurorin e Shtetit,

Data e Publikimit: 30.06.2015.

¹ Teksti i spastruar i ligjit nuk paraqet version zyrtar.

LIGJI Nr. 03/L-225 PËR PROKURORIN E SHTETIT

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit

Ky ligj themelon dhe rregullon organizimin, juridiksionin, funksionimin, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Prokurori i Shtetit** nënkupton institucionin e pavarur kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe veprave të tjera siç ceken me ligj dhe përfshinë si në vijim: prokuroritë themelore, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, dhe cilado njësi tjetër organizative që mund të krijohet për të ushtruar funksione prokuroriale.

1.2. **Kryeprokurori i Shtetit** nënkupton Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës sidhe menaxhmentin dhe kreun mbikëqyrës të Prokurorit të Shtetit.

1.3. **Kryeprokurori** nënkupton kreun e zyrës së prokurorit, duke përjashtuar Kryeprokurorin e Shtetit dhe Kryeprokurorin Prokurorisë Speciale.

1.4. **Kushtetuta** nënkupton Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

1.5. **Prokuror Special** nënkupton prokurorin e shtetit që shërben në Prokurorinë Speciale siç ceket në Ligjin mbi Prokurorinë Speciale, Nr. 2008/03-L052.

1.6. **Këshill** nënkupton Këshillin Prokurorial të Kosovës, siç ceket në Ligjin mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës.

KREU II PARIMET THEMELORE

Neni 3 Pavarësia dhe paanshmëria e Prokurorit të Shtetit

1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme.

2. Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe paparagjykime për të gjithë personat pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare, gjendjes apo të metave shëndetësore, apo pozitës shoqërore.

3. Është e kundërligjshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën për cilindo person fizik apo juridik që tëndërhyjë, pengojë, ndikojë apo të përpiqet të ndërhyjë, pengojë apo ndikojë të Prokurori i Shtetit gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale lidhur me cilindo hetim, procedurë apo lëndë individuale.

Neni 4

Ushtrimi i funksioneve prokuroriale

1. Në Republikën e Kosovës funksionet prokuroriale ushtrohen vetëm nga prokurorët e autorizuar dhe kompetentë të shtetit edhe prokurorët specialë siç ceket në Ligjin mbi Prokurorinë Speciale, të Republikës së Kosovës Nr. 2008/03L-052.

2. Një prokuror i shtetit i emëruar sipas rregullave është i autorizuar të iniciojë hetime penale, të paraqesë aktakuzën apo propozim akuzën, të zhvillojë ndjekjen penale apo të kryejë detyra apo funksione të tjeraprokuroriale që janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e zbatueshme.

Neni 5

Shumëllojshmëria etnike e Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit pasqyron shumëllojshmërinë etnike në Republikën e Kosovës, në pajtueshmëri me nenet 109(4) dhe 110(3) të Kushtetutës dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Neni 6

Efikasiteti i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit ushtron funksionet e veta në mënyrë efikase dhe efektive dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën, ligjet e zbatueshme dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht për mosdiskriminimin, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

KREU III

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E PROKURORIT TË SHTESTIT

Neni 7

Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve

1. Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit përfshijnë:

- 1.1. ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
- 1.2. zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
- 1.3. sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe kodin e etikës profesionale;
- 1.4. ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
- 1.5. mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar;
- 1.6. ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
- 1.7. marrjen e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
- 1.8. ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
- 1.9. ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
- 1.10. bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;
- 1.11. ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 8

Veprimtaritë parandaluese

Prokurori i Shtetit bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera publike dhe private në aktivitete lidhur me edukimin e shoqërisë me qëllim të ngritjes së njohurisë për ligjin dhe parandalimit të veprave penale.

Neni 9

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Kryeprokurori i Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, do të përcaktojë protokole dhe procedura për të ngritur bashkëpunimin me autoritetet e shteteve të tjera sa i përket ndjekjeve penale, përmes shkëmbimit të informacionit dhe mënyrave të tjera në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe marrëveshjet ndërkombëtare lidhur mes Kosovës dhe vendeve të tjera.
2. Kryeprokurori i Shtetit bashkëpunon me autoritetet dhe subjektet ndërkombëtare të vendosura në Republikën e Kosovës.

Neni 10
Marrëdhëniet me publikun

1. Prokurori i Shtetit i ofron publikut rregullisht informacione lidhur me veprimtaritë e saj.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, Prokurori i Shtetit nuk ofron asnjë informatë qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi që do të zbulonte sekretet zyrtare, do të rrezikonte një hetim apo procedure penale në zhvillim e sipër , do të dëmtonte integritetin, dinjitetin, sigurinë dhe të drejtat mbi privatësinë ecilitdo person, apo që do të shkelte të drejtat e të miturve.

KREU IV
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE JURIDIKSIONI I PROKURORIT TË SHTESTIT

Neni 11
Kryeprokurori i Shtetit

1. Kryeprokurori i Shtetit:

- 1.1. është kreu i Prokurorisë së Shtetit, me përgjegjësi për menaxhimin dhe përfaqësimin e Prokurorisë së Shtetit dhe të strukturave të prokurorive, të cilat e përbëjnë Prokurorinë e Shtetit;
- 1.2. cakton Zëvendësin e Kryeprokurorit të Shtetit, nga radhët e prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, i cili e zëvendëson Kryeprokurorin e Shtetit në mungesë të tij;
- 1.3. ka kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- 1.4. ka kompetencë ekskluzive për lëndë në shkallë të tretë pranë Gjykatës Supreme dhe mbi të gjitha lëndët që përfshijnë mjetet e jashtëzakonshme juridike;
- 1.5. nxjerr me shkrim rregulla, udhëzime dhe vendime të përgjithshme të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit;
- 1.6. mbikëqyr zbatimin e udhëzimeve dhe akteve tjera të përcaktuara në nënparagrafin 1.5 të këtij neni;
- 1.7. i propozon Këshillit për miratim rregullat mbi veprimtarinë dhe udhëheqjen e evidencës në prokurori;
- 1.8. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

2. Me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës ose për arsye tjera të rëndësishme, Kryeprokurori i Shtetit në bazë të një vendimi me shkrim, mund të marrë nën juridiksion cilindo rast në cilëndo prokurori në Republikën e Kosovës, ose ta ri-caktoj atë te një prokurori tjetër. Përveç elementeve

të përmendura, një vendim i tillë duhet të arsyetohet së paku neglizhencën, paaftësinë profesionale ose konfliktin e interesit të prokurorit/ve që e bëjnë të besueshëm një vendim të tillë.

Neni 12 **[Shfuqizuar]**

Neni 12/A **Bashkëpunëtorët profesional të Prokurorive**

Bashkëpunëtorët profesional dhe praktikantët në Prokurori, ushtrojnë funksionet e tyre në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Neni 13 **Kryeprokurori**

1. Kryeprokurori udhëheq me punën dhe përfaqëson prokurorinë për të cilin është emëruar.
2. Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore emërohen dhe shkarkohen në pajtim me ligjin.
3. Kryeprokurori është përgjegjës për punën e prokurorisë dhe për punën e vet i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial.
4. Kryeprokurorit i përgjigjen prokurorët e prokurorisë për punën e vet.
5. Secili Kryeprokuror i prokurorisë përkatëse mund të merr përsipër funksionin e ndjekjes penale në një lëndë konkrete që i është caktuar një prokurori vartës në atë prokurori me pëlqimin paraprak të Kryeprokurorit të Shtetit. Marrja e rastit duhet të bëhet me vendim të arsyetuar.
6. Në secilën prokurori ndarja e lëndëve bëhet sipas sistemit të rastësisë, bazuar në kriteret objektive. Këshilli obligohet që në afat prej tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të këtijligji të nxjerrë rregullore lidhur me ndarjen e lëndëve.
7. Kryeprokurorit të një prokurorie apo cilitdo prokuror tjetër të ndonjë prokurorie, Kryeprokurori i Shtetit apo prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i autorizuar nga ai, mund t'u jap udhëzime të detyrueshme me shkrim për punën konkrete.
 - 7.1. Udhëzime të tilla mund t'u japin prokurorëve në prokuroritë që drejtojnë edhe kryeprokurorët e prokurorive. Udhëzimet e tilla duhet të jenë të arsyetuara dhe nuk duhet të cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve, dhe në veçanti, nuk duhet të përmbajnë udhëzime për sa i përket kualifikimit të veprës, metodave të hetimit dhe mbledhjes së provave, si dhe arsyetimit të hetimit dhe aktakuzës.

7.2. Procedurat e brendshme i adresojnë rastet për të cilat do të nxirren udhëzime administrative dhe procedurat e brendshme hartohen për të adresuar situatat kur udhëzimi është ose joligjor ose në kundërshtim me ndërgjegjen e vartësit.

8. Udhëzimet jepen me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit.

9. Kryeprokurori i Shtetit apo Prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të autorizuar nga ai, mund të kërkojë raporte apo informata tjera me shkrim lidhur me progresin, gjendjen apo zgjidhjen e lëndëve të caktuara. Kërkesa e tillë duhet të bëhet me shkrim.

10. Secili nga kryeprokurorët e prokurorisë përkatëse mund të kërkojë raporte me shkrim apo informata të tilla nga një prokuror vartës.

11. Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët mund të delegojnë disa kompetenca tek vartësit e tyre.

Neni 14

Kompetencat dhe Organizimi i Prokurorisë së Shtetit

1. Prokuroria e Shtetit në Republikën e Kosovës organizohet dhe funksionon në përputhje me këtë ligj, si dhe me Ligjin për Prokurorinë Speciale.

2. Prokuroria e Shtetit është kompetente për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale, ushtrimin e mjeteve juridike nga kompetenca e tij, si dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

3. Kompetenca lëndore dhe territoriale e Prokurorisë së Shtetit përcaktohet sipas dispozitave ligjore me të cilin përcaktohet kompetenca e gjykatave, para të cilave i kryejnë autorizimet e veta, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

4. Prokurorinë e Shtetit e përbëjnë:

4.1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me seli në Prishtinë, si instanca më e lartë e Prokurorisë së Shtetit me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;

4.2. Prokuroria Speciale si organ prokurorial i specializuar, me juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi;

4.3. Prokuroria e Apelit, e cila përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda;

4.4. Prokuroritë Themelore të përbëra nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda.

5. Prokuroria themelore në Prishtinë, do të ketë udhëheqësin e Departamentit të Përgjithshëm, Departamentit për të Mitur dhe Departamentit të Krimeve të Rënda, të caktuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

6. Funksionet prokuroriale në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit i kryen Kryeprokurori i Shtetit dhe prokurorët në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

7. Funksionet prokuroriale në Prokurorinë e Apelit dhe në Prokuroritë Themelore i kryejnë kryeprokurorët dhe prokurorët e këtyre prokurorive, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

8. Funksionet prokuroriale në Prokurorinë Speciale kryhen në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 15 **Prokuroria Themelore**

1. Prokuroria Themelore ka juridiksion mbi të gjitha lëndët e shkallës së parë, përveq nëse është paraparë ndryshe më ligj.

1.1. Prokuroria Themelore themelohet me anë të këtij ligji me juridiksionin territorial të cekur si në vijim:

1.2. Prokuroria Themelore në Prishtinë, për territorin e Gjykatës Themelore të Prishtinës siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;

1.3. Prokuroria Themelore në Ferizaj, për territorin e Gjykatës Themelore të Ferizajit siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;

1.4. Prokuroria Themelore në Gjakovë, për territorin e Gjykatës Themelore të Gjakovës siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;

1.5. Prokuroria Themelore në Gjilan, për territorin e Gjykatës Themelore të Gjilanit siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;

1.6. Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për territorin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;

1.7. Prokuroria Themelore në Pejë, për territorin e Gjykatës Themelore të Pejës siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;

1.8. Prokuroria Themelore në Prizren, për territorin e Gjykatës Themelore të Prizrenit siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat.

Neni 16 **Prokuroria e Apelit**

1. Prokuroria e Apelit themelohet për të vepruar dhe përfaqësuar lëndët në Gjykatën e Apelit.
2. Prokuroria e Apelit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
3. Me pëlqimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, prokurori që ka vepruar në shkallë të parë në një lëndë konkrete mund ta shoqërojë dhe ndihmojë prokurorin e Prokurorisë së Apelit në seancën e shkallës së dytë në mbrojtjen apo kundërshtimin e ankesës.
4. Selia e Prokurorisë së Apelit është në Prishtinë.

Neni 17

Prokuroria Speciale

1. Juridiksioni territorial, fushëveprimi dhe kompetencat e Prokurorisë Speciale rregullohen ekskluzivisht me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale, të Republikës së Kosovës Nr. 2008/03-L052.
2. Përbërja e Prokurorisë Speciale dhe emërimi i Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale bëhet në bazë të Ligjit mbi Prokurorinë Speciale, të Republikës së Kosovës Nr. 2008/03-L052.

Neni 18

Themelimi i zyrave tjera

1. Kryeprokurori i Shtetit mund t'i paraqet kërkesë Këshillit Prokurorial të Kosovës për themelimin e zyrave të tjera në kuadër në sistemit prokurorial.
2. Në rast se Këshilli miraton themelimin e një zyre tjetër, atëherë do t'i paraqesë Kuvendit të Kosovës njëpropozim për plotësim buxhetor.

KREU V

KUALIFIKIMET, KRITERET DHE TË DREJTAT PËR EMËRIMIN E PROKURORËVE TË SHETIT

Neni 19

Kushtet e përgjithshme

1. Kandidatët për emërim për Prokurorë të Shtetit, duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. të ketë diplomën e fakultetit juridik të vlefshëm në Kosovë;
 - 1.3. të ketë të kryer provimin e jurisprudencës të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë;
 - 1.4. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;

- 1.5. të mos jetë i dënuar për vepër penale;
 - 1.6. të ketë së paku tre (3) vite përvojë në fushën juridike, dhe
 - 1.7. të ketë kaluar provimin për prokuror, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli.
2. Për qëllime të këtij neni përvoja në fushën juridike përfshin përvojën në çështje juridike në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përvojën si noter dhe përmbarues privat.

Neni 20

Kushtet për prokurorë të shtetit

1. Pas emërimit nga Presidenti i Kosovës, këta prokurorë, me përjashtim të atyre që kanë përvojë paraprake si prokuror, i nënshtrohen trajnimit fillestar që do të organizohet nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Trajnimi fillestar duhet të zgjasë dymbëdhjetë (12) muaj, në bazë legjislacionit në fuqi.
2. Gjatë trajnimit fillestar, prokurorëve nuk do t'u caktohen raste.
3. Prokurorët e emëruar do të vlerësohen pas rezultateve të trajnimit fillestar, në bazë të dispozitave relevante të ligjit. Periudha e trajnimit fillestar do të zgjatet për ata prokurorë që dështojnë ta përfundojnë në mënyrë adekuate trajnimin fillestar, siç është përcaktuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës.
4. Përveç kualifikimeve minimale, të gjithë kandidatët për emërim për prokuror të shtetit, me qëllim të emërimit apo avancimit në prokurori të caktuar duhet të kenë kualifikimet si në vijim:
 - 4.1. për të ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda apo për të Mitur në Prokurorinë Themelore, prokurori duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë si prokuror apo gjyqtar në lëmin penal si dhe bazuar në vlerësimin e performancës;
 - 4.2. për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Apelit, prokurori duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë si prokuror, nga të cilat tri (3) vite përvojë si prokuror në Departamentin e Specializuar të Prokurorisë Themelore ose në Prokurorinë Speciale të Republikës të Kosovës si dhe bazuar në vlerësimin e performancës;
 - 4.3. për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale, prokurori duhet të ketë së paku gjashtë (6) vite përvojë si prokuror, nga të cilat katër (4) vite përvojë si prokuror në Departamentin e Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore.
 - 4.4. për të ushtruar funksionin e prokurorit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, prokurori duhet të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë si prokuror si dhe bazuar në vlerësimin e performancës;

4.5. për të ushtruar funksionin e Kryeprokurorit të Shtetit prokurori duhet të ketë së paku tetë (8) vite përvojë pune si prokuror si dhe bazuar në vlerësimin e performancës.

Neni 20/A **Përfundimi i mandatit**

1. Mandati i prokurorit përfundon me:

- 1.1. dorëheqje;
- 1.2. shkarkim;
- 1.3. vdekje;
- 1.4. me arritjen e moshës së pensionimit;
- 1.5. me humbjen e aftësive të punës për shkaqe mjekësore të vërtetuara, dhe;
- 1.6. nëse nuk riemërohet me mandat të përhershëm.

Neni 21 **Kompensimi i prokurorëve të shtetit**

1. Gjatë periudhës së shërbimit, prokurorët e shtetit gëzojnë pagat bazë si në vijim:

- 1.1. kryeprokurori i Shtetit pranon pagë ekuivalente me atë të Kryetarit të Gjykatës Supreme.
- 1.2. prokurorët me mandat të përhershëm në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- 1.3. kryeprokurori i Prokurorisë Speciale pranon pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë e pesë (95) % me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- 1.4. prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë Speciale marrin pagë ekuivalente me pagën e prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
- 1.5. kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit merr pagë ekuivalente me pagën e kryetarit të Gjykatës së Apelit;
- 1.6. prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë e Apelit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.

1.7. kryeprokurorët e prokurorive themelore marrin pagë ekuivalente me kryetarët e gjykatavethemelore.

1.8. secili prokuror me mandat të përhershëm në Prokurorinë Themelore pranon pagë jo më pakse shtatedhjetë përqind (70%) e pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore. Këshilli do të nxjerr skemën për kompensime shtesë që pasqyron përgjegjësitë e veçanta të prokurorit që paraqitet para Departamentit të Krimeve të rënda pranë Gjykatës Themelore, por në asnjë rastshuma e pagës bazë dhe pagesës shtesë nuk do të kalojë nëntëdhjetë përqind (90%) të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore.

1.9. përpos pagës së tyre bazë, secili prokuror gëzon të drejtën për kompensim shtesë për shërbimetjera siç ceket me ligj apo rregulla të nxjerra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

1.10. pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e ligjit, paga e prokurorëve të shtetit nuk do të zvogëlohet gjatë periudhës së shërbimit të tyre përpos nëse kjo caktohet si sanksion nga Këshilli Prokurorial apo Komisioni Disiplinor i Këshillit bazuar në përcaktimin se prokurori i shtetit ka kryer sjellje të pahijshme a pondonjë vepër penale.

1.11. prokurorët kanë të drejtë në pushim në pajtim me Ligjin përkatës të Punës.

Neni 22 Mbrojtja

Prokurorët kanë të drejtë që nga Këshilli Prokurorial i Kosovës të kërkojnë masa të veçanta mbrojtëse për veten dhe për familjet e tyre atëherë kur kërcënim i për jetën e tij apo të një anëtar të familjes vjen si rezultat i ushtrimit të funksionit të tyre prokurorial apo buron nga ai.

Neni 23 Imuniteti

1. Prokurorët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni për veprimete ndërmarra, vendimet e marra, apo mendimet e shprehura që janë brenda fushëveprimit të përgjegjësitë të tyre.

2. Prokurorët nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni nëse kanë kryer shkelje të qëllimshme të ligjit.

3. Kur një prokuror akuzohet apo arrestohet, ai/ajo duhet ta njoftojë pa vonesë Kryeprokurorin e Shtetit.

Neni 24 Trajnimi i prokurorëve të shtetit

1. Prokurorët kanë të drejtë në trajnim profesional të duhur për t'iu mundësuar ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre prokuroriale, siç është e përcaktuar nga Këshilli.

2. Kryeprokurori i Shtetit, së bashku me Këshillin, shqyrton programet trajnuese për prokurorët dhe bënëpërmirësime të nevojshme për të siguruar përshtatjen, efikasitetin dhe dobinë.

Neni 25

Veprimtaritë profesionale

1. Prokurorët kanë të drejtë që me aprovimin e Këshillit, të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të prokurorëve.

2. Prokurorët, jashtë orarit të punës, me vendim të Këshillit, mund të angazhohen në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe Sjelljen profesionale të prokurorëve.

3. Në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes profesionale, prokurorët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve prokuroriale gjatë apo pas përfundimit të funksionit prokurorial, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor të lëshuar nga Këshilli.

4. Prokurorët që pranojnë shpërblim për këto aktivitete, nuk mund të tejkalojnë vlerën prej njëzet e pesë përqind (25%) të pagës bazë, për pjesëmarrje në veprimtari të parapara sipas këtij neni dhe për këtë shpërblim e njoftojnë Këshillin.

Neni 26

Sjellja e prokurorëve

1. Prokurorët nuk do të përdorin statusin si prokuror apo reputacionin e prokurorisë për të avancuar tëdrejtat apo interesat e tyre personale.

2. Prokurorët nuk do të kryejnë asnjë detyrë apo shërbim tjetër që mund të ndërhyjë në pavarësinë dhepaanshmërinë e tyre apo që në ndonjë mënyrë tjetër mund të mos jetë në përputhje me ushtrimin e funksionit të prokurorit.

3. Prokurorët nuk do të angazhohen në çfarëdo funksioni apo veprimtari politike, përfshirë anëtarësinë në parti politike ose kandidimin apo mbajtjen e pozitës politike. Prokurorët inkurajohen të votojnë por nuk mund të marrin pjesë në zgjedhje apo veprimtari politike. Mbajtja e pozitës politike është nëospajtueshmëri me ushtrimin e funksionit të prokurorit.

4. Sjellja e prokurorit duhet të jetë në përputhje me dispozitat e parashtruara në Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve.

KREU VI

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 27

Tranzicioni i Prokurorive

1. Ky ligj do të zbatohet sipas orarit në vijim:

1.1. faza e planifikimit: nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2011, Këshilli do të përgatisë planin e zbatimit për të lehtësuar kalimin nga sistemi aktual prokurorial tek sistemi prokurorial I themeluar sipas këtij ligji. Deri më datë 1 dhjetor, 2011 Këshilli do të postojë në faqen e vet të internetit planin e zbatimit.

1.2. faza e zbatimit: nga data 1 janar 2012 deri më 31 dhjetor 2012, Këshilli do të vazhdojë me planin e vet të zbatimit.

Neni 28

Përgjegjësitë e Këshillit Prokurorial gjatë fazës së planifikimit dhe zbatimit

1. Gjatë fazës së planifikimit Këshilli do të shpallë rregullore lidhur me çështjet kalimtare dhe operative të cilat paraqiten si të nevojshme sipas këtij ligji.

2. Gjatë fazës së planifikimit, Këshilli do të zhvillojë një plan të detajuar për zbatim që përfshinë, por që nuk kufizohet me sa vijon:

2.1. caktimin, ri caktimin dhe transferimin e lëndëve tek prokuroritë përkatëse me juridiksion territorial apo material për ato lëndë;

2.2. caktimin e personelit;

2.3. transferimin e pajisjeve fizike në mes prokurorive;

2.4. caktimin dhe transferimin e prokurorëve në zyrat dhe pozitat përkatëse siç është paraparë me këtë ligj, duke marrë parasysh dhe duke i dhënë rëndësinë e duhur emërimeve dhe vendimeve të marrura gjatë procesit gjithëpërfshirës të riemërimit dhe ngarkesës me lëndë për secilën prokurori; dhe

2.5. të gjitha çështjet e tjera që ndikojnë në kalimin e sistemit prokurorial në strukturën e themeluar me këtë ligj si dhe për funksionimin efikas në të ardhmen të prokurorive.

3. Këshilli do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për organizimin, planifikimin dhe zbatimin e plotë të dispozitave të këtij ligji dhe për të siguruar kalim të lehtë në strukturën e re prokuroriale.

Neni 29

Përfundimi i lëndëve të pazgjidhura

1. Të gjitha lëndët të cilat më datë 31 dhjetor 2012 janë lëndë të shkallës së tretë në cilëndo prokurori dhe të cilat nuk janë përfunduar me vendim të formës së prerë nga gjykata, më datë 1

janar 2013 do të trajtohen si lëndë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

2. Të gjitha lëndët të cilat më datë 31 dhjetor 2012 janë lëndë të shkallës së dytë në cilëndo prokurori dhe të cilat nuk janë përfunduar me vendim të formës së prerë nga gjykata,, më datë 1 janar 2013 do të trajtohen si lëndë të Prokurorisë së Apelit.

3. Të gjitha lëndët të cilat më datë 31 dhjetor 2012 janë lëndë të shkallës së parë në cilëndo prokurori dhe të cilat nuk janë përfunduar me vendim të formës së prerë nga gjykata,, më datë 1 janar 2013 do të trajtohen si lëndë të Prokurorisë Themelore përkatëse e cila ka juridiksionin mbi territorin përkatës.

Neni 30

Vlefshmëria e akteve të mëparshme

Të gjitha veprimet e mëparshme të autoriteteve prokuroriale lidhur me lëndët që në atë kohë ishin nën autoritetin e tyre të ligjshëm dhe që janë marrë para transferimit të kompetencave të cekura me këtë ligj, do të mbesin në fuqi përveç nëse këto shfuqizohen nga ndonjë vendim pasues i gjykatës apo nga ndonjë direktivë nga Kryeprokurori i Shtetit ose Këshilli sipas këtij ligji.

Neni 31

Buxheti

Për zbatimin e plotë të këtij ligji, Qeveria e Kosovës do të sigurojë fonde adekuate nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

KREU VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 32

Shfuqizimi i ligjeve tjera

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen ligjet në vijim:

1.1. Ligji mbi Prokurorinë Publike të Krahinës Autonome të Kosovës

1.2. Rregullorja e UNMIK-ut nr.1999/05, Për themelimin e Gjykatës ad hoc të instancës së fundit dhe të zyrës ad hoc të Prokurorisë Publike.

1.3. cilido ligj tjetër deri në masën që është në mospërputhshmëri me dispozitat e këtij ligji.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji cilido referim në cilindo ligj, rregullore, urdhëresë, rregull apo ndonjë akt tjetër juridik për “Shërbime Prokuroriale” apo “Prokuror Publik” do të interpretohen që të kenë kuptimin e “Prokurorit të Shtetit”.

3. Asgjë në këtë ligj nuk do të interpretohet apo zbatohet për të ndryshuar, kufizuar, zgjeruar apo për të ndryshuar në ndonjë formë tjetër autoritetin, juridiksionin, pushtetin apo detyrat e caktuara të Prokurorisë Speciale të përcaktuara me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale, Nr. 2008/03-L052.

Neni 32/A
Dispozitat kalimtare

1. Gjatë kohëzgjatjes së mandatit të EULEX-it në Kosovë, Kryeprokurori i Shtetit nuk mund të marrë nën juridiksion raste që i janë caktuar një prokurori të EULEX-it, pa pëlqimin e Kryeprokurorit të EULEX-it.

2. Statusi i stafit administrativ i nënshtrohet parimeve të shërbimit civil dhe do të rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Nenet 21, 28 dhe 29 hyjnë në fuqi sipas nenit 80 (6) të Kushtetutës. Pjesa tjetër e këtij ligji hyn në fuqi më 1 janar 2013.